



## Menaxhimi elektronik i burimeve bibliografike me platformën Zotero

Organizuar nga Zyra e Ekselencës

Data: 8 Prill 2025

Adresa: Biblioteka Shkencore e Universitetit

Forma e organizimit: Trajnim me pjesëmarrje fizike

### Rreth trajnimit

Zyra e Ekselencës në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" organizon më 8 prill 2025, në ambientet e Bibliotekës Qendrore, një trajnim për shkrimin akademik me temë: *"Hyrje në Zotero – Menaxhimi elektronik i burimeve bibliografike."*

Në një kohë kur kërkohen standarde gjithnjë e më të larta për transparencë, rreptësi metodologjike dhe bashkëpunim të strukturuar në kërkimin shkencor, menaxhimi elektronik i burimeve bibliografike është kthyer në një domosdoshmëri institucionale. Zotero, si një platformë falas dhe me burim të hapur, u mundëson studiuesve të mbledhin, organizojnë, ruajnë dhe citojnë burime në formate të standardizuara ndërkombëtare (si APA, MLA, Chicago etj.), duke u integruar në mënyrë të drejtpërdrejtë me Word, LibreOffice dhe Google Docs.

Ky trajnim synon të mbështesë stafin akademik të të gjitha njësive në përvetësimin e një qasjeje të unifikuar dhe të standardizuar për menaxhimin e literaturës, e cila ndihmon jo vetëm në rritjen e cilësisë së dorëshkrimeve, por edhe në rritjen e efikasitetit të bashkëpunimit në grupet kërkimore. Kur të gjithë anëtarët e një skuadre kërkimore përdorin Zotero, ata mund të krijojnë një bibliotekë të përbashkët që përditësohet në kohë reale. Për shembull, kur njëri prej bashkëautorëve shton referenca gjatë rishikimit të një manuskripti, të gjithë anëtarët e tjerë të grupit – nëse përdorin Zotero dhe kanë sinkronizuar bibliotekën – i marrin automatikisht këto referenca të përditësuara, pa nevojë për transferim manual apo korigjim të bibliografisë. Ky funksionalitet jo vetëm që parandalon gabimet në citim dhe ndihmon në ruajtjen e koherencës bibliografike, por gjithashtu kursen kohë dhe përforcon ndarjen efektive të detyrave brenda grupit.



Zotero mundëson edhe ndarje tematike të literaturës sipas kapitujve, projekteve apo fushave, çka ndihmon kërkuesit të kenë qasje të shpejtë dhe të saktë ndaj burimeve përkatëse.

Trajnimi do të trajtojë funksionalitete bazë dhe të avancuara të Zotero-s, si: instalimi dhe konfigurimi fillestar, organizimi i koleksioneve, përdorimi i shtojcave për citim automatik, krijimi i grupeve të bashkëpunimit, modifikimi i stileve të citimit dhe integrimi me platforma të tjera kërkimore. Pjesë e rëndësishme e sesionit do të jetë gjithashtu një fazë praktike e dedikuar për instalimin në pajisjet personale dhe asistencë teknike për përdoruesit fillestarë.

Nëpërmjet krijimit të një kulture të përbashkët kërkimore digjitale, të bazuar në standarde të njësuara për menaxhimin e literaturës, ky trajnim kontribuon drejtpërdrejt në objektivat strategjike të universitetit për ngritjen e kapaciteteve akademike, ndërkombëtarizimin dhe promovimin e ekselencës në kërkim dhe publikime shkencore.

### Agjenda e Trajnimit

Orari	Veprimtaria	Drejtues	Komente
10:30 – 11:00	Veprimtari për instalimin e Zotero	Noel Radovani, Specialist/Webmaster	Udhëzime teknike për shkarkimin dhe konfigurimin fillestar
11:00 – 11:40	Prezantim dhe ilustrim me shembuj praktikë	Elvisa Drishti, PhD	Demonstrim i funksioneve kryesore të Zotero dhe përdorimit në procesin akademik
11:40 – 12:00	Pyetje dhe diskutime me pjesëmarrësit	Elvisa Drishti, PhD & Noel Radovani, Specialist/Webmaster	Diskutim i hapur mbi përdorimin, përvojat dhe nevojat e stafit
12:00 – në vijim	Veprimtari shtesë për instalimin dhe asistencë teknike	Noel Radovani, Specialist/Webmaster	Mbështetje individuale për pjesëmarrësit që kanë nevojë për ndihmë shtesë teknike